



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 201/1 Prot.

Tiranë, më 27.03.2015

VENDIM

Nr. 25, datë 27/03/2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/**Qendra “Res Publica”** ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 201 Prot., datë 06.03.2015, ndaj autoritetit publik/**Këshillit të Ministrave**, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”. Ankuesi nëpërmjet shkresës nr.028/15Prot, datë 11.02.2015., ka kërkuar nga Këshilli i Ministrave, *Kopje të vendimit të Këshillit të Ministrave për miratimin e tabelave për kategorizimin e përqindjeve të përfitimit të ndihmës juridike sipas numrit të anëtarëve, që personi ka në përbërjen e tij/saj familjare dhe të ardhurave mujore mesatare të familjes së tij sipas nenit 13/4 të ligjit 10039 datë 22.12.2008, “Për ndihmën juridike”, i ndryshuar*. Ankuesi pretendon se kërkesa e tij nuk është trajtuar sipas afatit ligjor të përcaktuar në nenin 15/1 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, nga Autoriteti Publik.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri pas vlerësimit të ankesës së Qendrës “Res Publica”, me Urdhrin nr.54 datë 06.03.2015, urdhëroi kryerjen e inspektimit administrativ pranë Autoritetit Publik/Këshillit të Ministrave.

Gjatë inspektimit, u konstatua se nga Autoriteti Publik nuk është kryer asnjë veprim për trajtimin e kërkesës. Kjo edhe për arsye se informacioni i kërkuar nuk ka të përcaktuar saktë objektin e kërkesës. Kërkuesi ka përmendur vetëm fushën e veprimtarisë që rregullon akti duke mos cituar nr. dhe datën e VKM-së, të dhëna të cilat e bëjnë atë të identifikueshëm.

Autoriteti Publik, në kuptim të nenit 12, pika 1 të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, duhet të kontaktojë me kërkuesin e informacionit për të saktësuar kërkesën e bërë dhe më pas të vendos në dispozicion të kërkuesit, dokumentacionin e kërkuar.

Komisioneri vlerëson se dokumenti i kërkuar (në rast të plotësimit të kushteve të nenit 12/1 dhe identifikimit të aktit), në kuptim të nenit 7 pika 1 gërma b) iii) dhe pika 3, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, përbën një informacion që bëhet publik pa kërkesë.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

V E N D O S A:

1. Autoriteti Publik/Këshilli i Ministrave të plotësojë detyrimin dhe afatin e përcaktuar në nenin 12, pika 1 të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
2. Autoriteti Publik/Këshilli i Ministrave të japë informacionin e kërkuar, në rast të saktësimit të objektit të kërkesës, sipas pikës 1 të këtij vendimi.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ky vendim u dha sot në datë 27.03.2015.

